



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. \_\_\_\_ prot.

Tiranë, më 11.9.2020

**Lënda:** Bisedimet përfundimtare të Komisionerit Publik në seancën gjyqësore të datës 11.9.2020, para trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, për çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit znj. Donika Prea, konfirmuar në detyrë me vendimin nr.103, datë 5.2.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

**Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”

**Drejtuar:** Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

Të nderuar anëtarë të trupit gjykues,

Në referencë të nenit 302 dhe 303 të Kodit të Procedurës Civile, pasi u shqyrtuan dhe iu nënshtruan debatit gjyqësor të gjitha shkaqet e ankimit, prapësimet e palëve dhe provat e administruara, Komisioneri Publik, në përfundim, duke iu përmbajtur parashtrimeve të paraqitura në këtë gjykim në seancat e datave 17 korrik dhe 3 shtator, konstaton se pretendimet dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit nuk arritën të provojnë të kundërtën e secilit shkak ankimi.

Komisioneri Publik, në qëndrimin e tij lidhur me aktet e reja që subjekti i rivlerësimit depozitoi pranë trupit gjykues, ka argumentuar se ato nuk pasqyrojnë vlerë të shtuar mbi provueshmërinë e fakteve që përmban ankimi, duke u qëndruar në këtë mënyrë të gjithave shkaqeve të ankimit të paraqitur.

**I. Për sa i përket kriterit të vlerësimit të pasurisë**

Gjatë hetimit administrativ të Komisionit, mbi vlerësimin e kriterit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit lidhur me ligjshmërinë e të ardhurave të deklaruara nga subjekti dhe personi i lidhur me të, ka rezultuar se nuk janë paguar të plota detyrimet tatimore mbi të ardhurat e bashkëshortit. Në vendimin e Komisionit ka gjetur pasqyrim po ashtu edhe trajtimi i elementit subjektiv të personit të lidhur/subjektit të rivlerësimit, në lidhje me dijeninë për pagesën ose jo të detyrimeve tatimore.

Komisioneri Publik, lidhur me të ardhurat e ligjshme të familjes së subjektit të rivlerësimit, ashtu sikurse ka trajtuar gjerësisht në shkaqet e ankimit dhe parashtrimet gjatë shqyrtimit gjyqësor, i qëndron interpretimit të pikës 3, të nenit D, të aneksit të Kushtetutës, interpretim i cili tashmë gjyqësisht ka gjetur pasqyrim në jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit, ku, për efekt të procesit të rivlerësimit, konsiderohen të ardhura të ligjshme të ardhura të cilat: (i) janë deklaruar dhe (ii) për të cilat vërtetohet pagimi i detyrimeve tatimore sipas legjislacionit në fuqi.

Gjithashtu, Komisioneri Publik vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk provoi po ashtu mungesën e pretenduar të dijenisë së saj dhe të personit të lidhur me të, mbi shmangien e detyrimeve tatimore për periudhën e punësimit të bashkëshortit të saj pranë shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k.

Nga aktet e vëna në dispozicion nga vetë subjekti, të nënshkruara personalisht nga bashkëshorti i saj, ka rezultuar se paga e bashkëshortit është tërhequr pjesërisht në llogarinë bankare të tij dhe pjesërisht në *cash* pranë arkës së shoqërisë. Pretendimi i subjektit të rivlerësimit mbi mosdijeninë, për më tepër, mbetet i pajustificuar si një pretendim ligjor, për shkak edhe të njohurive profesionale të posaçme të subjektit të rivlerësimit.

Në këto kushte, aktet dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit gjatë këtij gjykimi në lidhje me pagesat e detyrimeve tatimore pas depozitimit të ankimit të Komisionerit Publik, duhet të merren me rezervë në këtë proces, pasi janë veprime të kryera gjatë këtij procesi dhe për shkak të tij. Komisioneri Publik, në parashtrimet e tij, në seancën e kaluar, solli në vëmendje të këtij trupi gjykues se Kolegji ka trajtuar tashmë në praktikën e tij raste kur subjekti i rivlerësimit, gjatë procedurës gjyqësore të apelimit, me qëllim legjitimimin e të ardhurave, ka kryer *a posteriori* pagesën e detyrimeve tatimore të papaguara, duke gjetur interpretim, edhe në këtë rast, ekzistenca ose jo e ligjshmërisë së këtyre të ardhurave.

Për Komisionerin Publik, shqyrtimi gjyqësor i kësaj çështjeje nga ana juaj, mbi bazën e shkaqeve të ankimit, bazuar në nenin 179/b, pika 5, të Kushtetutës, nenin C, pika 2, nenin F, pika 2 dhe 3, të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, provoi se:

*1. Lidhur me burimet e ligjshme për të krijuar pasurinë: “Apartament banimi”, i ndodhur në Tiranë*

Subjekti i rivlerësimit gjendet: **(i)** Në kushtet e mungesës së burimeve financiare të ligjshme për të realizuar kursimet e deklaruara në vitin 2006, për një diferencë negative prej – 533.186 lekë, pas konsiderimit edhe të provave dhe pretendimeve të reja të subjektit në parashtrimet e seancës së datës 17.7.2020; **(ii)** Në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për mbulimin e pagesës së kësteve të apartamentit nga të ardhurat e vitit 2007, për një diferencë negative prej – 450.240 lekë; **(iii)** Në kushtet e mungesës së dokumentimit të plotë të marrëdhënies së huas me shtetasin \*\*\*.\*\*\*, për shumën 15.000 euro: *(iii.i)* Subjekti, në konsideratë të akteve të paraqitura në seancën e datës 17.7.2020, nuk arriti të provojë me dokumentacion ligjor burimin e ligjshëm të të ardhurave të shtetasit \*\*\*.\*\*\* për të dhënë hua shumën 15.000 euro; *(iii.ii)* mundësinë për të shlyer me të ardhura të ligjshme nga burime të ligjshme të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të, këtë hua në vitin 2008, për një diferencë negative prej – 405.697 lekë.

1.1 Komisioneri Publik çmon se pretendimi i subjektit, se ka vend të zbatohet neni 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, për pamundësinë për të siguruar dokumentacion mbi të ardhurat e shtetasit \*\*\*.\*\*\* përpara vitit 2002, nuk qëndron, pasi, sikurse është trajtuar gjerësisht në parashtrimet e

seancës së mëparshme, është në kontradiktë me aktet e paraqitura nga vetë subjekti gjatë hetimit administrativ.

1.2 Në këto kushte, për këtë pasuri, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk provoi mbulimin me të ardhura nga burime të ligjshme, të blerjes së këtij apartamenti, duke rezultuar në kushtet e deklarimit të pamjaftueshëm dhe të pasaktë, në kuptim të nenit D, pikat 1 dhe 3, të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, për një diferencë negative prej – 2.810.126 lekë.

## 2. *Lidhur me pasurinë likuiditetet/llogari bankare në shumën 4.501.427,89 lekë*

2.1 Komisioneri Publik, pa kaluar në përsëritje të argumenteve të shkaqeve të ankimit mbi ligjshmërinë e të ardhurave të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të, vlerëson se aktet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për këtë shkak ankimi, nuk provuan mbulimin me të ardhura të ligjshme nga burime të ligjshme për blerjen e pasurisë: apartament në Durrës, shitja e të cilit ka shërbyer si burim për krijimin e pasurisë: depozitë bankare.

2.2 Në këto kushte, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk provoi krijimin e kësaj pasurie me të ardhura nga burime të ligjshme, duke rezultuar në kushtet e deklarimit të pamjaftueshëm dhe të pasaktë, në kuptim të nenit D, pikat 1 dhe 3, të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, për një diferencë negative prej –1.579.162 lekë.

## 3. *Lidhur me transaksione monetare të padeklaruar*

### 3.1.(i) *Hua në shumën 25.000 euro, në vitin 2011*

3.1.1 Komisioneri Publik, për këtë shkak ankimi, çmon se nuk është provuar e kundërta nga prapësimet dhe aktet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit. Bazuar në nenin 4 të ligjit nr. 9049/2003, të ndryshuar, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të kanë detyrimin të deklarojnë pasuritë e luajtshme, interesat private, të krijuara këto sipas parashikimeve të dispozitave përkatëse të Kodit Civil.

3.1.2 Pretendimet e subjektit të rivlerësimit dhe aktet e paraqitura prej saj gjatë procesit të rivlerësimit, pas evidentimit të kësaj marrëdhënieje financiare të padeklaruar nga institucionet përkatëse, nuk gjejnë pasqyrim në përmbajtjen e akteve shkresore.

3.1.3 Në këto kushte, për këtë shkak ankimi, mbetet konkluzioni se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur është përpjekur të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në posedim ose përdorim të tij, në kuptim të nenit D, pika 5, të aneksit të Kushtetutës, për një diferencë negative financiare (– 3.510.950 lekë).

### 3.2 (ii) *Transaksion bankar, pagesë cash, në shumën 1.755.000 lekë, në vitin 2013*

3.2.1 Komisioneri Publik, për këtë shkak ankimi, çmon se edhe pas prapësimeve dhe akteve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, nuk u provua lidhja, shkaku ligjor dhe qëllimi i kryerjes së transaksionit nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, pranë ZVRPP-së Durrës, në muajin prill të vitit 2013, periudhë në të cilën bashkëshorti i subjektit ka qenë i punësuar pranë Bashkisë Tiranë, ndërkohë që marrëdhëniet e punësimit me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k. ishin ndërprerë prej nëntorit të vitit 2011.

3.2.2 Sa më sipër, pretendimet e subjektit mbeten në nivel deklarativ, duke mbetur si i vetmi veprim juridik i provuar, kreditimi i një vlere prej 1.755.000 lekë, nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, për shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k., veprim ky i padeklaruar në deklaratat vjetore dhe në Deklaratën “Vetting”.

3.2.3 Në këto kushte, konstatojmë se, në përfundim të analizës së provave/akteve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për këtë shkak ankimi, mbetet konkluzioni se subjekti i rivlerësimit dhe

personi i lidhur është përpjekur të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në posedim ose në përdorim të tij, në kuptim të nenit D, pika 5, të aneksit të Kushtetutës.

## **II. Për sa i përket vlerësimit të kriterit të aftësive profesionale (denoncimet e publikut, sjellja e subjektit gjatë procesit të rivlerësimit)**

*4 Lidhur me të dhënat nga raporti mbi vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, përgatitur nga Prokuroria e Përgjithshme*

4.1 Në referencë të shkaqeve të ankimit, prapësimeve dhe akteve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit gjatë këtij gjykimi, Komisioneri Publik çmon se elementet e konstatuara në raportin profesional të hartuar nga Prokuroria e Përgjithshme, si dhe në aktet e administruara lidhur me procedimet penale në ngarkim të shtetasve \*\*\*.\*\*\* dhe \*\*\*.\*\*\*, janë elemente që duhen konsideruar nga Kolegji në rivlerësimin e subjektit, znj. Donika Prela, bazuar në vlerësimin tërësor të procedurave, sipas nenit 4, pika 2 dhe nenit 61/5 të ligjit nr. 84/2016.

*5 Lidhur me të dhënat nga denoncimet e ardhura pas depozitimit të ankimit*

5.1 Në referencë të shkaqeve të ankimit, prapësimeve dhe akteve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit gjatë këtij gjykimi, Komisioneri Publik i qëndron parashtrimeve të paraqitura në seancën e datës 3.9.2020, duke vlerësuar se ato mund t'i shërbejnë vlerësimit tërësor në përputhje me nenin 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, dhe mbeten për t'u çmuar nga trupi gjykues i Kolegjit.

*6 Sjellja e subjektit gjatë procesit të hetimit*

6.1 Në referencë të sjelljes së subjektit dhe bashkëpunimit gjatë procesit të rivlerësimit, sikurse parashikon neni 48 i ligjit nr. 84/2016, dhe vlerësimit të etikës profesionale, Komisioneri Publik, ashtu sikurse trajtuar dhe në parashtrimet e seancës së datës 3.9.2020, vlerëson se të dyja rastet e kërkesave për përjashtim të anëtarëve të trupit gjykues, të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, duhen konsideruar si një përpjekje për të vonuar seancën dhe, në përgjithësi, për të vonuar procesin e saj të rivlerësimit, sjellje e cila duhet të merret parasysh nga ky trup gjykues në vlerësimin përfundimtar të subjektit, në kuptim të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit bashkëpunimi dhe sjellja e subjektit të rivlerësimit me Kolegjin, është faktor me rëndësi në vendimmarrjen gjatë procesit.

6.2 Komisioneri Publik vlerëson se sjellja e subjektit të rivlerësimit, në të dyja rastet e paraqitjes së kërkesës për përjashtim, duhet të vlerësohet nga Kolegji në analizë të vlerësimit etiko-profesional, në kuadër të vlerësimit të përgjithshëm sipas nenit 4, pika 2, në lidhje me nenin 48 dhe 61/5, të ligjit nr. 84/2016.

## **III. Kërkimi përfundimtar i ankimit**

7. Në përfundim të këtyre parashtrimeve, Komisioneri Publik vlerëson se:

7.1 *Për kriterin e pasurisë*, Komisioneri Publik, në përfundim të analizës së provave/akteve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për sa më sipër trajtuar, duke përfunduar për kontrollin e kriterit të pasurisë, me një diferencë negative, vlerëson se subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e deklaramit të pasaktë, të paplotë, të pamjaftueshëm dhe jo në përputhje me ligjin, në kuptim të

pikës 1, 3 dhe 5, të nenit D, të aneksit të Kushtetutës, nenit 33, pika 5, shkronjat “a” dhe “b”, dhe nenit 61, pikat 3 dhe 5, të ligjit nr. 84/2016;

7.2 *Për kriterin e aftësive profesionale dhe nga vlerësimi tërësor i çështjes*, në interpretim të nenit E, të aneksit të Kushtetutës, nenit 4, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, për subjektin e rivlerësimit duhet të gjejë zbatim neni 61, pika 5 e këtij ligji.

7.3 Bazuar në dispozitën e pikës 3 dhe 7, të nenit F, të aneksit të Kushtetutës, shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 66, të ligjit nr. 84/2016, kërkohet nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelit të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit nr.103, datë 5.2.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Donika Prela, magjistrate/prokurore, pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**KOMISIONERI PUBLIK**

**Florian BALLHYSA**